REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: "Dërgimin në gjyq të çështjes penale, që i përket procedimit penal nr. 34, të vitit 2024, në ngarkim të të pandehurit **Namik Koçi**, i akuzuar për kryerjen e veprës penale *"Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike"*, parashikuar nga neni 244/2 i K.Penal".

2. Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua me rregullat e gjykimit të shkurtuar. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Flora Hajredinaj, Etleva Deda dhe Bib Ndreca, me vendimin Nr. **28**, datë **10.04.2025** vendosi:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Namik Koçi**, për veprën penale *"Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike"* parashikuar nga neni 244 paragrafi i dytë i Kodit Penal, dhe dënimin e tij me **1 (një) vit burgim.**
2. Në bazë të nenit 406 pika 1 të K.Pr.Penale, të pandehurit **Namik Koçi** i ulet 1/3 e dënimit, për shkak të aplikimit të gjykimit të shkurtuar, dhe përfundimisht dënohet me **8 (tetë) muaj burgim.**
3. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, dhe vënia në provë e të pandehurit **Namik Koçi** për një afat prove **një 1 (vit) e 4 (katër) muaj**, gjatë së cilës i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale, dhe të mbajë kontakte me Drejtorinë e Shërbimit të Provës, që mbulon vendbanimin e tij. Afati i provës fillon pas marrjes formës të prerë të vendimit nga momenti i kontaktit të parë të të pandehurit me shërbimin e provës.
4. Shuarjen e masës së sigurimit "detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore" sipas nenit 234 të Kodit të Procedurës Penale, të caktuar ndaj të pandehurit **Namik Koçi**, me vendimin nr.18, datë 24.02.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
5. **Në lidhje me provat materiale:**
   -Shuma prej 70.000 lekësh e sekuestruar gjatë hetimit paraprak, sipas procesverbalit përkatës datë 20.02.2024, të konfiskohet si mjet që ka shërbyer për kryerjen e veprës penale, bazuar në nenin 36 të K.Penal.
   -Shuma prej 215.000 lekë si dhe aparatet të markës Iphone 15 pro max, t'i kthehen të pandehurit Namik Koçi.
   -Aparati Iphone 13 pro Max, t'i kthehet shtetases V.Ll.
   -Aparati Iphone 12 pro Max, t'i kthehet shtetases H.K.

-Paisjet HDD që përmbajnë aktet e ekspertimit në lidhje me telefonat e ekspertuar si dhe të USB me materialet e këqyrura, të mbeten pjesë e fashikullit të këtij gjykimi.

6. Shpenzimet procedurale, ato të kryera gjatë fazës së hetimit paraprak në shumën 9.066,44 (nëntëmijë e gjashtëdhjetë e gjashtë presje dyzet e katër) lekë, dhe ato të kryera gjatë shqyrtimit gjyqësor, sipas formularit bashkëngjitur këtij vendimi, i ngarkohen të pandehurit Namik Koçi.
7. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, duke filluar nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Tiranë, më datë 10.04.2025

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar